



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.19

Prishtinë, më 14.07.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Bekim Haxhiu, Mufera Sinik dhe Teuta Haxhiu.

Mungoi: Shukrije Bytyqi dhe Srdjan Popović.

Pjesëmarrës të tjerë: Blendina Krasniqi-UNDP (praktikante), Bekim Kodraliu-OSBE, Albana Bajrami-Rtk Radio, Ukë Gashi-ZPRK, Leotrim Berisha-Tribuna, Avni Uka-Bota Sot.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 01.07.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 01.07.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 01.07.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore

Nait Hasani, tha se në këtë mbledhje do të kemi mundësi ti shqyrtojmë edhe një herë amendamentet e bëra për Projektligjin për Provimin e Maturës. Komisioni vayhdoi me shqyrtimin e amendamenteve si vijon:

Amendamenti 1

Neni 1 dhe riformulohet si vijon “Me këtë Ligj rregullohet funksioni, përmbajtja, kushtet, kriteret, mënyra e organizimit dhe procedurat e provimit të maturës shtetërore”.

Amendamenti 2

Neni 2 pika 1 dhe ndryshohet si vijon “Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë këtë kuptim” dhe ky amendament vlen për gjithë nenin, në nenin 1 pika 1.1 inkorporohet propozimi i MASHT-it i cili është si vijon “Matura Shtetërore është vlerësim i arritjeve të njohurive, shkathtësive dhe aftësive të nxënësve të cilët i kanë fituar gjatë arsimimit parauniversitar në përputhje me kurrikulën e Republikës së Kosovës, apo përcaktimi i nivelit të kompetencave të arritura të nxënësve dhe lejimi i atyre që të vazhdojnë arsimimin në nivelin universitar”, pikët tjera të këtij neni riformulohen si vijon, pika 1.2 Kandidat - është nxënësi, personi i cili e përfundon me sukses klasën përfundimtare të arsimit të mesëm të lartë, pika 1.3 Administruesit dhe Mbikëqyrësit - janë persona të cilët caktohen nga organet kompetente për administrimin dhe mbikëqyrjen e testimit, pika 1.4 Vëzhguesit - të akredituar nga Komisioni, pika 1.5. Test i standardizuar - është testi i përpiluar dhe harmonizuar në pajtim me karakteristikat metrike të testeve që janë sajuar nga një institucion i profesionalizuar për hartimin e testeve të tilla, pika 1.9. KSHM - Komisioni Shtetëror i Maturës.

Amendamenti 3

Neni 3 inkorporohet propozimi i Këshillit Rinor dhe riformulohet si vijon “Provimi i Maturës Shtetërore mbahet me test të standardizuar, në kushte të barabarta për të gjithë kandidatët të cilët i nënshtrohen provimit, njëkohësisht duke i ndjekur të njëjtat procedura dhe rregulla bazuar në kriteret e vlerësimit”.

Amendamenti 4

Neni 5 titulli riformulohet si vijon “Të drejta e Kandidatit”, dhe pikët tjera riformulohen si në vijim, pika 1. Kandidati i nënshtrohet provimit të maturës shtetërore në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë, pika 2. Kandidati me nevoja të veçanta i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore sipas kushteve dhe kriterëve që u përshtaten nevojave të tyre, pika 3. Provimit të maturës shtetërore i nënshtrohen edhe kandidatët nga arsimi për të rritur dhe pika 4. Kushtet dhe kriteret e vlerësimit të kandidatëve me nevoja të veçanta dhe kandidatëve të arsimit për të rritur do të përcaktohen me akte nënligjore të veçanta.

Amendamenti 5

Neni 6 titulli riformulohet si vijon “Kandidati i ardhur nga jashtë” dhe nenet riformulohen si në vijim, pika 1. Kandidati i cili jashtë Kosovës ka marrë dëftesën e klasës së fundit të shkollës së mesme të lartë e cila është e nostrifikuar në Kosovë, ka të drejtë të hyjë në provimin e maturës shtetërore, pika 2. Kandidati i nënshtrohet provimit aty ku e cakton MASHT, bazuar në dokumentin e nostrifikuar për drejtimin përkatës në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe pika 3. Kandidati duhet t’i plotësojë kushtet e hyrjes në provim si të gjithë kandidatët e tjerë.

Amendamenti 6

Neni 7 riformulohet si vijon, pika 1. MASHT është autoriteti shtetëror përgjegjës për organizimin e provimit të maturës shtetërore në bashkëpunim me: 1.1. Komisionin Shtetëror të Maturës (KSHM), 1.2. Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), 1.3. Shkollat e mesme të Larta, 1.4. Komisionet e qendrave të testimit dhe pika 2. Pasi të themelohet Agjencia e Kosovës për Kurikulum, Standarde dhe Vlerësim përgjegjësia për organizimin e provimit të maturës shtetërore bartet nga MASHT tek Agjencia

Amendamenti 7

Neni 8 titulli riformulohet si vijon “Komisioni Shtetëror i Maturës” dhe riformulohen këto pikë, 1. Komisioni Shtetëror i Maturës (KSHM), është organ vendimmarrës, mbikëqyrës, organizativ dhe këshillues për maturën, pika 2. Komisioni Shtetëror i Maturës ka njëmbëdhjete (11) anëtarë të emëruar me mandat tre vjeçar (3) në këtë përbërje: 2.1. MASHT tre (3) anëtarë, 2.2. Institucionet e arsimit të lartë tre (3) anëtarë, 2.3. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës një (1) anëtar, 2.4. DKA një (1) anëtar, 2.5. Përfaqësues nga drejtorët e shkollave të mesme të larta nga gjimnazet dhe shkollat profesionale dy (2) anëtar, 2.6. Përfaqësuesi i Këshillit të Prindërve të Kosovës një (1) anëtarë. 3. Ministri emëron Komisionin Shtetëror të Maturës, duke pasur parasysh barazinë gjinore dhe etnike.

Amendamenti 8

Pas nenit 8 shtohet një nen i ri, neni 9 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit Shtetëror të Maturës, pika 1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Shtetëror të Maturës janë: 1.1 Miraton listën e anëtarëve të komisioneve të lëndëve për përpilimin e kërkesave për provimin shtetëror të maturës me propozimin e DVSM, pika 1.2. Miraton planin e punës për organizimin e provimit të maturës për vitin vijues të hartuar nga DVSM, më së largu deri më 31 gusht, pika 1.3. Merr opinionet nga komuniteti për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit dhe mbi këto opinione nxjerr udhëzime për subjektet në procesin e provimit të maturës, pika 1.4. Miraton katalogun dhe bën harmonizimin e lëndëve për provimin e maturës, në përputhje me planprogramet mësimore sipas drejtimeve respektivisht profileve, me propozimin e DVSM, pika 1.5. Publikon rezultatet e testit me MASHT dhe pika 1.6. Përcakton standardet për administrim të provimit të maturës shtetërore.(i bartur nga neni 9 me disa ndryshime)

Amendamenti 9

Neni 9 riformulohet si vijon,

1. Obligimet dhe përgjegjësitë e DVSM:

1.1. Harton teste të standardizuara bazuar në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, të miratuara nga MASHT. 1.2. Propozon dhe trajnon mbikëqyrësit, administruesit, anëtarët e komisioneve si dhe individë të tjerë të përfshirë në procesin e provimit të maturës shtetërore.

1.1. Përgatit bazën e të dhënave për kandidatet e provimit të maturës shtetërore.

1.2. Përgatit dhe publikon materiale bazë dhe informuese jo me vone se në muajin tetor.(i ri)

1.5. Gjatë tërë vitit përgatit dhe publikon materiale ndihmëse për provimin e maturës shtetërore.

1.6. Përgatit dhe shpërndan udhëzues për shkollat e mesme të larta dhe DKA për organizimin e programeve përgatitore për kandidatët që do t'i nënshtrohen provimit të maturës.

1.6. Organizon dhe mbikëqyrë procesin e shtypjes, paketimit, shpërndarjes dhe kthimit të materialeve për provimin e maturës shtetërore

1.7. Bën kontrollimin dhe përpunimin e të dhënave të kandidatëve dhe përgatit rezultatet për shpallje

1.8. Përgatit raportin për ecurinë e testit të maturës dhe raportin teknik për provimin e maturës.

1.9. Publikon materialet bazë, udhëzuesit informativ dhe rezultatet e provimit të maturës shtetërore në ueb faqen e MASHT.

1.12. Krijon dhe procedon mënyrën e informimit rreth shpalljes dhe dokumenteve tjera për provimin e maturës në faqen elektronike dhe në media.

Amendamenti 10

Neni 10 riformulohet pika 1.1. Shpallja e njoftimit për vendimin ministrit në lidhje me organizimin e provimit të maturës, pika 1.2. Caktimi i detyrave dhe obligimeve për drejtorët e shkollave në lidhje me mbajtjen e provimit të maturës sipas udhëzimeve të KSHM dhe DVSM, pika 1.3. Siguron të dhënat e sakta dhe me kohë për kandidatët që do të vlerësohen përfshirë edhe kandidatët me nevoja të veçanta, pika 1.4. Propozon mbikëqyrësit dhe administruesit sipas udhëzimeve të DVSM, pika 1.5. Cakton objektet për qendra të testimit, pika 1.6. Koordinon punët shkollë - DVSM dhe KSHM, pika 1.7. Brenda tre (3) dite raporton me shkrim për mbarëvajtjen e procesit të provimit të maturës shtetërore, pika 1.8. Analizon rrjedhat dhe rezultatet e provimit të maturës shtetërore në nivel të shkollave, pika 1.9. Propozon dhe ndërmerr masa për ngritjen e cilësisë bazuar në rezultatet dhe analizat, pika 1.10. Gjatë kohës së administrimit të testit angazhon ekipet e shërbimit shëndetësor dhe pika 2. Kryen edhe punë të tjera të cilat i caktohen nga organet mbikëqyrëse.

Amendamenti 11

Pas nenit 11 shtohet, neni i ri si vijon: Shkolla e mesme e Lartë,

1. Detyrat dhe përgjegjësit e shkollës së mesme të lartë janë :

1.1. Përgatit listën e kandidateve që i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore dhe i dërgon në DKA.

1.2. Përgatit hapësirën për mbajtjen e provimit të maturës shtetërore sipas udhëzimeve KSHM

1.3. Përgatit dhe ofron program mbështetës për provimin e maturës shtetërore.

Në nenin 11 pika 1 riformulohet si vijon 1. Komisioni në qendrat e testimit përbëhet nga tre (3) anëtarë. Dy (2) anëtarë nga DKA dhe një (1) nga MASHT që i propozon DVSM dhe pika 2.

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit të qendrës së testimit rregullohen me akt nënligjor.

Amendamenti 12

Neni 12 riformulohet si vijon, pika 1. Administruesit dhe mbikëqyrësit i cakton DVSM në bazë të propozimeve të DKA dhe institucioneve të arsimit të lartë, pika 2. Puna e administruesve dhe

mbikëqyrësve të provimit të maturës shtetërore monitorohet nga KSHM, DVSM dhe Komisioni i qendrës së testimit, pika 3. Detyrat dhe përgjegjësitë e administruesve dhe mbikëqyrësve rregullohen me akt nënligjor dhe pika 4. Komisioni, administruesi, mbikëqyrësi dhe anëtarët e Komisionit të cilët nuk veprojnë sipas rregullave të parapara sanksionohen në bazë të nenit 29 paragrafi 3. (sipas renditjes)

Amendamenti 13

Në nenin 13 pika 1 riformulohet si vijon “Afatin dhe datën e organizimit të provimit të maturës shtetërore i cakton Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”.

4. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime për këtë pikë të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani